



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 531/11 Prot.

Tiranë, më 17.05 / 2023

NJOFTIM
Për
SHPALLJEN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Drejtor/e Artistik pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar neni 7 pika 1; neni 9 pika 1, gërma ç; dhe neni 13; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014” “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme të Institucionit nr.1850 prot datë 25.07.2014; të shpallë 1 vend vakant për pozicionin e punës: **Drejtor/e Artistike pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.**

Kandidatët për pozicionin e punës duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

Drejtor/e Artistike pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.

-Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

- 1.Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
- 2.Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 3.Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
- 4.Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- 5.Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje e certifikuar nga shteti i tij;
- 6.Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

-Kandidati/ja duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë i diplomuar në nivelin Mastër në degën dirizhim orkestre brenda ose jashtë vendit nga një universitet ose institut ekuivalent.

Preferohet që kandidati/ja të ketë edhe një diplomë ose PHD në drejtësi, ekonomi ose administrim biznesi brenda ose jashtë vendit nga një univeristet, ose institut ekuivalent.

2. Kandidati/ja të ketë mbajtur detyrën e drejtorit artistik në një teatër, fondacion opere ose orkestër shtetërore për të paktën 5 vjet. Preferohet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale të dokumentuar në fushën e menaxhimit dhe drejtimit të projekteve të ndryshme;

3. Të ketë aftësi të dallueshme komunikimi në ruajtje dhe zhvillim të kontakteve brenda dhe jashtë institucionit, si dhe me partnerët vendorë e ndërkombëtarë;

4. Të ketë njohuri minimalisht të 3 gjuhëve të huaja, të detyrueshme anglisht dhe italisht;

5. Të ketë një biografi që demonstroi një karrierë me njohje të qartë ndërkombëtare;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

-Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Jetëshkrim (CV);
2. Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara në shtetin përkatës;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore, ose një dokument ekuivalent me të;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore, ose një dokument ekuivalent me të;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

-Kandidatët do të vlerësohen për platformën , biografinë dhe intervistën e strukturuar me gojë, në bazë të një pikëzimi si më poshtë detajuar:

- Platforma artistike të zhvillimit të veprimtarisë artistike të Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë -40 pikë;
- Biografia -30 pikë;
- Intervista e strukturuar me gojë -30 pikë;

Totali 100 pikë

Përshkrimi përgjithësues i punës:

1. Drejtori Artistik i OF, në përputhje me platformën drejtuese të Drejtorit të Përgjithshëm propozon platformën artistike të zhvillimit të veprimtarisë artistike të Operas dhe Filarmonisë.
2. Drejtori Artistik i OF i propozon Drejtorit të Përgjithshëm objektivat e performancës artistike të drejtorisë së tij përgjatë vitit artistik, në përputhje me objektivat e drejtorit të përgjithshëm si dhe ai është përgjegjës për zbatimin e tyre.

3. Drejtori Artistik i OF i propozon drejtorit të përgjithshëm kalendarin vjetor artistik të drejtorisë së tij.
4. Drejtori Artistik i OF drejton dhe organizon punën e stafeve artistike për implementimin e kalendarit artistik.
5. Drejtori Artistik i OF në bashkëpunim me përgjegjësit e sektoreve planifikon planin e provave.
6. Drejtori Artistik i OF drejton provat muzikore të sektorëve në varësi.
7. Drejtori Artistik i OF negocion me partnerë vendas dhe të huaj për organizimin e turneve brenda dhe jashtë vendit.
8. Drejtori Artistik i OF i propozon Drejtorit të Përgjithshëm projekte bashkëpunimi me subjekte apo individë artistë brenda dhe jashtë vendit.
9. Drejtori Artistik i OF i propozon Drejtorit të Përgjithshëm thirrje për aplikim për projekte alternative të artit klasik dhe kontemporan etj.....
10. Drejtori Artistik i OF bën thirrje (audicione) për rolet specifike për kalendarin artistik.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 15/06/2023.

Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nëpërmjet numrit të tyre të kontaktit ose postës elektronike e-mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë, për vendin vakant **Drejtor Artistik, Drejtorja e Operas dhe Filarmonisë.**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta. Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në TKOBAP, do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail-it) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të TKOBAP-së.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

